



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2019:123636  
Datë: 25.01.2021  
Numri i dokumentit: 01436322

**C.nr.73/2016**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtarja Kaltrinë Haliti, në çështjen kontestimore të paditësit I. A nga Gjilani, të cilin me autorizim e përfaqëson Halit Azemi, avokat nga Gjilani, kundër të paditurit P. V. C nga Gjilani, me adresë NTP “N. B”,..., me objekt kontesti pagim borxhi, në vlerë 6,000.00€ pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, më datën 19.01.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET** si e pa bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit I. A nga Gjilani e ushtruar kundër të paditurit P. V. C ... , me objekt të kontestit pagim borxhi, në lartësi prej 6,000.00€, me të cilën ka kërkuar që të obligohet i padituri P. V. C..., që paditësit I. A t’ia paguaj çmimin kontraktues prej 6,000.00€ (gjashtë mijë euro), në emër të çmimit të shitblerjes së makinës së udhëtarëve të markës ... me kamat bankare prej 4.5% të cilin e paguajnë bankat me mjetet e deponuara për një vit pa destinime të veçanta, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

**II.** Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

**A r s y e t i m**

Paditësi pranë kësaj gjykate më dt. 29.12.2015, ka ushtruar padi kundër të paditurit me objekt kontesti pagimin e borxhit në vlerë 6,000.00€.

Gjykata pas pranimit të padisë duke vepruar konform nenit 394 dhe 395 të LPK-së, të paditurit ia ka dërguar aktvendimin për përgjegje në padi në mënyrë që i njejtë ti paraqes pretendimet e tij lidhur me padinë e paditësit, mirëpo nga i njejtë nuk ka pranuar parashtresë për përgjegje në padi.

**I autorizuari i paditësit** si në shqyrtimin përgatitor, kryesor, ashtu edhe në shpjegimet përfundimtare ka deklaruar se: mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke theksuar se me shtjellimin e provave dëgjimin e paditësit dhe dëshmitarëve është vërtetuar se i padituri e ka marrë makinën e udhëtarëve të markës ..., për shumën e të hollave 6,000.00€ në muajin Janar të vitit 2013, i cili kishte pasur obligim që deri në maj të vitit 2013 t'ia paguaj çmimin kontraktues, mirëpo këtë nuk e kishte bërë edhe pse paditësi disa herë ia ka kërkuar përmbushjen e detyrimit përmes telefonit dhe në shtëpi të të paditurit, por pa sukses, për çka edhe është detyruar të ushtrojë padi pranë gjykatës. Këto pohime i vërtetojnë edhe dëshmitarët se i padituri nga shtëpia e paditësit pasi që janë marrë vesh në restorant e ka marrë makinën e udhëtarëve të markës ... dhe çmimin për të nuk e ka paguar. Prandaj nga të lartëcekurat i ka propozuar gjykatës që ta aprovojë në tërësi si të bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe ta obligojë të paditurin që paditësit t'ia paguaj çmimin kontraktues në shumën prej 6,000.00€, me kamat bankare 8%<sup>1</sup> sipas dispozitave të LMD-së duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore edhe atë për padinë e ushtruar si dhe tri seanca të mbajtura në shumë prej 540€ sipas TA.

**I padituri** si në shqyrtimin përgatitor, kryesor, ashtu edhe në shpjegimet përfundimtare, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar në prova dhe fakte, duke theksuar se nuk është e vërtetë se ky ia ka borxh shumën në lartësi prej 6,000.00€ I. A, në mes tjerash i njëjti i ka kërkuar provat edhe atë dokumentet e noterizuara me të cilat edhe do të vërtetohej borxhi i pretenduar.

**Në shqyrtimin kryesor të mbajtur me dt.19.01.2021 paditësi I. A i dëgjuar në cilësi të palës në mes tjerash ka deklaruar se:** Veturën ... e kam blerë nga P. V. C me çmim 6,000.00€ dhe të cilin çmim e kishte paguar në tërësi me para në dorë, veturën pas blerjes nuk e kishte vozitur sepse e njeta kishte qenë me tabela të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe për këtë arsye ky e kishte mbajtur në garazhin e shtëpisë së tij, sepse nuk kishte mundur ta regjistronte pa u kthyer librezë e veturës së çregjistruar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Një muaj e gjysëm pas blerjes kishte shkaur në restorantin e tij në Restorant ..., P. V. C, ku i kishte kërkuar t'ia kthente veturën sepse i duhej për ti realizuar disa spote muzikore me të, fillimisht nuk kishte dashur t'ia kthente por pastaj ia kishte kthyer dhe i kishte thënë që t'ia kthente parat të cilat ia kishte dhënë për blerjen e kësaj veture dhe i padituri i kishte thënë se me dt. 01.05.2013 do t'ia kthente parat, gjë të cilës ky i kishte

<sup>1</sup> Përfaqësuesi i paditësit në fjalën përfundimtare e ka kërkuar kamatën ligjore 8%, ndërsa gjatë tërë rrjedhës së procedurës duke filluar nga padia fillestare e deri në shqyrtimin kryesor e ka kërkuar kamatën 4.5%, ashtu që gjykata nuk e mori për bazë këtë ndryshim të kërkesë lidhur me kamatën në fjalën përfundimtare.

bësuar. Pas dhënies së veturës e kishte thirur në telefon P. V. C disa herë por i njejtë asnjë herë nuk kishte mundur të kontaktonte me të sepse nuk ia kishte hapur telefonin, pastaj kishte shkuar në shtëpinë e tij ku nuk e kishte takuar nënën e tij e gjithashtu në lokalën e familjarëve të tij ku e kishte njoftuar babain e tij dhe i njejtë i kishte thënë se mua nuk më intereson kjo punë.

**Në shqyrtimin kryesor të mbajtur me dt.19.01.2021 i padituri P. V. C i dëgjuar në cilësi të palës në mes tjerash ka deklaruar se:** Veturën e markës ... e kam blerë personalisht dhe ajo veturë ka qenë e imja, këtë veturë e kam blerë në Pejë dhe e njejtë ka qenë me tablera të Amerikës, këtë veturë unë e kam regjistruar vet me tabela RKS dhe pastaj e kam shitur, por nuk më kujtohet kujt ia kam shitur. Unë nuk e mbaj në mend që ndonjëherë këtë veturë t'ia kem dhënë në shfrytëzim apo përdorin I. A. Në restorantin ... kam qenë shumë herë mirëpo asnjëherë për shitjen apo blerjen e kësaj veture, gjithashtu nuk më kujtohet që unë ndonjëherë të kem qenë në shtëpinë e I. A e ta kem marrë veturën ... pasi që kjo veturë ka qenë e imja dhe nuk ka qenë e I. e gjithashtu nuk është e vërtetë që I. ka shkuar në shtëpinë time apo në lokalën e bizneseve të familjarëve të mij apo ti këtë njoftuar vëllezërit e mi se kinse unë ia kam borxh parat për blerjen e kësaj veture.

Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje civilo-juridike, në shqyrtimin kryesor të mbajtur më dt. 19.01.2021, gjykata bëri administrimin dhe leximin e këtyre provave edhe atë: deklaratat e dëshmitarëve I. M dhe J. M e gjithashtu i ka dëgjuar palët ndërgjyqëse në cilësi të palës.

**Në shqyrtimin kryesor të mbajtur me dt.19.01.2021 dëshmitari J. M në mes tjerash ka deklaruar se, nuk është në raport familjar me palët ndërgjyqëse:** Fillimisht para se të deklarohej e potencoi faktin se ka kaluar një kohë e gjatë dhe nuk i kujtohet ngjarja se si ka ndodhur, i njejtë ka shtuar faktin se nuk ka qenë prezent kur është shitur vetura (nuk ka njohuri lidhur me këtë fakt) por i njejtë kishte qenë prezent kur i padituri P. V. C, veturën ... , e kishte marrë nga shtëpia e paditësit, ky ia kishte dorëzuar qelësin e veturës, çmimi i kësaj veture ishte bërë fjalë të ketë qenë 6000€, nuk e dinë faktin se ai e kishte marrë veturën sepse e kishte blerë apo e kishte marrë vetëm në shfrytëzim. Më vonë kishte dëgjuar nga I. se atë veturë ia kishte shitur të paditurit dhe i padituri nuk ia kishte paguar çmimin për blerjen e veturës.

**Në shqyrtimin kryesor të mbajtur me dt.19.01.2021 dëshmitari I. M, në mes tjerash ka deklaruar se, është në raport familjar me paditësin, përkatësisht bashkëshortja e tij paditësin e ka djalë të axhës:** I njejtë në momentin kur paditësi ia kishte dorëzuar veturën të paditurit e kishte shoqëruar me veturë paditësin nga Restoran ... deri në shtëpinë e tij, përkatësisht ky

kishte qendruar brenda në veturë duke e pritur I. që t'ia jepte qelësat e veturës blerësit të ri. Gjatë rrugës për në shtëpi paditësi i kishte thënë se po shkojë në shtëpi për t'ia dorëzuar qelësin e veturës blerësit sepse e kam shitur veturën, viti i sakt se kur ka ndodhur kjo nuk i kujtohej. I njeti u deklarua se e ka parë se nga shtëpia e I. të këtë dalur P. V. C me veturën e udhëtarëve të markës Mini Coper, (asgjë tjetër nuk ka parë, dmth bëhej fjalë për dorëzimin e çelsave të veturës), ndërsa nuk ka njohuri tjetër lidhur me çmimin apo mënyrën e shitjes së kësaj veture.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjygjëse dhe provave të nxjera në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e **pabazuar**.

Pas vlerësimit me kujdesë të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku si dhe në bazë të rezultatit të procedurës së zhvilluar kontestimore, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike.

Kontestuese për palët ndërgjygjëse ishte çështja e shitjes së veturës së udhëtarëve të markës ... dhe pagimi i çmimit për atë veturë.

Se paditësi I. A , kinse ia ka shitur veturën e udhëtarëve të markës ... të paditurit P. V. C në shumën në lartësi 6000€, e për të cilën i padituri asnjëherë nuk ia kishte paguar çmimin për blerjen e saj, fakt ky i pa vërtetuar në provat e paraqitura në këtë proces juridiko kontestimor.

Nga dëgjimi i dëshmitarit J. M gjykata vërtetoi faktin se ky kishte qenë dëshmitar kur i padituri e kishte marrë veturën e udhëtarëve të markës ... , nga shtëpia e paditësit, ndërsa nuk e dinte se i padituri e kishte marrë atë veturë sepse e kishte blerë apo e kishte marrë në shfrytëzim. I njeti ishte marr në dijeni më vonë se kinse paditësi t'ia këtë shitur veturën të paditurit. Gjithashtu deklarata e këtij dëshmitari ishte kontradiktore me deklaratën e paditësit të dëgjuar në cilësi të palës sepse dëshmitari J. M i dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt. 19.01.2021 ka deklaruar se “ e ka dëgjuar paditësin I. A , kur ka biseduar në telefon me të paditurin P. V. C, dhe kur ia ka kërkuar parat për veturën të cilën ia kishte shitur..”, ndërsa paditësi I. A , i dëgjuar në cilësi të palës ka deklaruar se të paditurin e kishte thirrur në telefon për t'ia kërkuar parat për shitjen e veturës mirëpo asnjëherë të vetme nuk kishte arritur të kontaktoj me të paditurin sepse ky i fundit nuk ia kishte hapur asnjëherë telefonin. Andaj nga të lartëcekurat gjykata nuk ia fali besimin deklaratës së këtij dëshmitari.

Nga dëgjimi i dëshmitarit I. M gjykata nuk arriti të vërtetoj faktin se paditësi I. A t'ia ketë shitur veturën e udhëtarëve të markës ... , të paditurit P. V. C, sepse i njeiti ka deklaruar se nuk ka njohuri lidhur me çmimin dhe mënyrën e shitjes së kësaj veture, nuk ka qenë prezent kur kjo ka ndodhur, mirëpo i njeiti vetëm e ka parë që nga shtëpia e paditësit të këtë dalur i padituri me veturën e markës ... .

Andaj, nga dëgjimi i dëshmitarëve të lartëcekur gjykata nuk arriti të vërtetoj me saktësi faktin se me të vërtet paditësi I. A t'ia ketë shitur veturën e udhëtarëve të e markës ... të paditurit P. V. C., pasi që asnjëri nga ta nuk kishte qenë prezent kur ishte bërë shitblerja e kësaj veture dhe nuk kishin asnjë njohuri lidhur me çmimin dhe mënyrën se si ishte bërë shitblerja e gjithashtu gjatë rrjedhës së kësaj procedure vihej në dyshim fakti se a ishte bërë shitblerja apo fare nuk kishte pasur shitblerje të veturës e cila është objekt i këtij kontesti.

Ndërsa sa i përketë propozimit të përfaqësuesit të paditësit, për aprovimin e kërkesëpadisë kjo gjykatë nuk e aprovoi meqenëse i njeiti përpos që nuk ishte bindës dhe mjaftueshëm i argumentuar, nuk ishte në koherenc me asnjë nga provat e shtjelluara e të cilave kjo gjykatë nuk ia fali besimin, duke shtuar faktin se paditësi nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi materiale e as dëshmitar që do të provonin që palët ndërgjyqëse me të vërtet ishin dakorduar që veturën e udhëtarëve të markës ... fillimisht e ka blerë paditësi nga i padituri e pastaj i padituri të njejtën vetur e ka blerë nga paditësi dhe i njeiti për atë vetur duhej të paguante çmimin në lartësi prej 6,000.00€, dhe meqenëse nga provat e administruara nuk mundi të konstatojë asnjë fakt me siguri, prandaj edhe aplikoi rregullat e barrës së provës duke u mbështetur në nenin 322 të LPK-së, i cili në mënyrë shprehimore paraqet mënyrën e veprimit dhe vendosjes sipas të cilit ” ***Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (Neni 8 të këtij ligji) nuk mund ta konstatoj me siguri ndonjë fakt, për egzistimin e faktit do të përfundojë duke aplikuar rregullat mbi barrën e provës***”, e poashtu sipas paragrafit 2 dhe 3 të po këtij neni ku thuhet se “***Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër, sikurse dhe pala e cila e konteston egzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar së ekzistuari po që se ligji nuk parasheh diç tjetër***”, andaj, gjykata në këtë kontest duke aplikuar këto rregulla vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi e refuzoi kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar.

Gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi që secila nga palët t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore, duke u bazuar në nenin 450 të LPK-ës, pasi që pala paditëse e ka humbur kontestin ndërsa i paditurit nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga arsyet e cekura më lartë e bazuar në nenin 142 pika 1 dhe 2 të LPK-se dhe nenit 262 të LMD-ës vjetër, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

**Departamenti i Përgjithshëm**

**C.nr. 73/2016, dt. 19.01.2021**

**Gjyqtarja,**

**Kaltrinë HALITI**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditë, pas ditës së pranimi të vendimit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:123636  
Datë: 25.01.2021  
Numri i dokumentit: 01436322